



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E
MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 395/prot.

Tiranë, më 08.11.2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1361, datë 08.06.2009.

**SHOQËRISË “GAÇAJ 5” SH.P.K
Lagjia “Kushtrimi” Vlorë.**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “Gaçaj 5” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1361, datë 08.06.2009, për mineral ranor silicor, në objektin “Rauliçio, Tërbaç”, Vlorë.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.233 prot., datë 09.01.2018, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me nr.395 prot., datë 09.01.2018, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1361, datë 08.06.2009, për mineral ranor silicor, në objektin “Rauliçio, Tërbaç”, Vlorë, për arsye se nuk është filluar puna akoma në objektin për të cilën shoqëria juaj është pajisur me leje, duke shkelur afatet e përcaktuara, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij.

Me shkresën nr.10, datë 15.01.2018 protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.790 datë 15.01.2018, nga shoqëria juaj është bërë kërkesë, ku kërkoni rishikim të masës së revokimit të lejes dhe paraqisni argumentet tuaja se mos realizimi i treguesve për të cilët është marrë leja ka ardhur nga mungesa e tregut. Në këtë kërkesë, anashkaloni shkakun për të cilin propozohet revokimi i lejes në fjalë, që nuk ka filluar puna në objekt, që nga momenti që është marrë leja. Aktualisht është në përfundim afati 10vjeçar i vlefshmërisë së saj. Për vitin në vazhdim thoni në kërkesën tuaj që keni bërë marrëveshje me subjekte të ndryshme që garantojnë shitjen e prodhimit, por edhe pse kanë kaluar 10 muaj, nuk keni dërguar ndonjë informacion për punën në objekt, që të mbështesë argumentet tuaja.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim, është i mbështetur në paragrafi “II” të germës “b” të pikës ,1 të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1361, datë 08.06.2009, për mineral ranor silicor, në objektin “Rauliçio, Tërbaç”, Vlorë, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1361, datë 08.06.2009, për mineral ranor silicor, në objektin “Rauliçio, Tërbaç”, Vlorë.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

ME AUTORIZIM

ZËVENDËSMINISTRI

ENIS ALIKO

